



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P 515/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.08.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Rean 95” sh.p.k nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-63112-04-17-2018 me objekt “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i pjesshëm i skemave ujitëse dhe sifonave të Mustafa Koç, Rovë (Ballçiflik), Alltatë”, me fond limit 183,333 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 30.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

**Ankimues:**

“Rean” 95 shpk  
Rruga “Musa Karapici”, Nr.6 Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia e Tiranës  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për

*organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili nuk e ka pranuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 17.04.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr. REF-63112-04-17-2018 me objekt “*Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i pjesshëm i skemave ujitëse dhe sifonave të Mustafa Koç, Rovë (Ballçiflik), Alltatë”*”, me fond limit 183,333 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 30.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2 . Në datën 30.04.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 11.05.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Leni-Ing	pa ofertë	I skualifikuar
- G&L	pa ofertë	I skualifikuar
- HE&SK 11 11	150,000	I skualifikuar
- Mak Studio	159,499	I skualifikuar
- Rean 95	166,350	I skualifikuar
- Novatech Studio	166,666	I kualifikuar
- B-VAAL Engineering	166,666	I skualifikuar
- Instituti i Konslences ne Ndërtim	169,752	I kualifikuar
- A.SH Engineering	170,000	I skualifikuar

II.4. Në datën 11.05.2018 operatori ekonomik “Rean 95” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

*Operatori ekonomik nuk ploteson Seksionin dy të dokumentave standarte të tenderit: II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË Seksioni 1. Hartimi i ofertës Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë. Duke rënë në kundërshtim me Kriteret e përcaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit si dhe VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin me nr 402 datë 13.05.2015 me vendimin nr 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797 datë 29.12.2017. Në rastin konkret operatori ekonomik ka paraqitur dy formulare oferte sipas shtojcës 1 përkatësisht 166.350 leke pa tvsh si dhe 78.143,33 leke pa tvsh. Gjithashtu në të dy rastet e mësipërme të ofertave ekonomike: Operatori ekonomik "Rean" Studio shpk, nuk ka respektuar VKM Nr. 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", cituar në paragrafin e fundit të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. "Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. Datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim". Kjo Bazuar në njoftimin e bërë me Nr. 5585 datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë 11.05.2016 "Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", si dhe njoftimit Nr. Prot 13565 datë 06.11.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Terheqje Vemendje", ku kërkohet detyrimisht zbatimi i akteve ligjore, nenligjore dhe VKM 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim". Sa më sipër u konstatua se vlera e ofertës ekonomike të ofertuar nga Operatori Ekonomik nuk është në përputhje me VKM 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" pasi është më e ulët se vlera minimale e përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor, për këtë procedurë. Bazuar në Rekomandimin e APP-së Nr. 5585 datë 25.07.2017 "Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në VKM Nr.354*

*date 11.05.2016 "Per Miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim, pika 2, Shprehimisht thuhet se: "Ne rrethana te jashtezakonshme dhe nese dokumentohet me shkrim, tarifat mund te jene me ulta se sa normat minimale, te specifikuara nga ky manual" Ne rastin kur operatori ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanen e jashtezakonshme, Autoriteti Kontraktor gjate vleresimit*

*te ofertes duhet ti referohet vleres minimale te perlllogaritur per kete procedure prokurimi ne baze te parashikimit te VKM Nr. 354 date 11.05.2017 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" Ne rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nese ndodhet ne rrethana te jashtezakonshme per proceduren e prokurimit me objekt: Loti i Dytë: "Mbikqyrja e punimeve për objektin: "Rehabilitimi i pjesshëm i skemave ujitëse dhe sifonave të Mustafa Koç, Rovë (Ballcifik), Alltatë", Per sa me siper theksojme se eshte detyre e operatorit ekonomik te garantoje qe oferta e paraqitur te jete ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi si rrjedhoje konkudojme se dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik "Rean" Studio shpk, nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Respektim te VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim".*

II.5. Në datën 16.05.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Ju bëjmë me dije se udhëzimi nr.5585 datë 25.07.2017 i përket procedurës blerje e vogël jo kërkesë për propozime. Megjithatë diferenca prej 316 lekë pa tvsh më pak se vlera e konkurentit të kualifikuar nuk përbën shkak për skualifikim. AK për ta vlerësuar tenderin duhet të botojë edhe fondin limit të investimit me qëllim që cdo operator të bëjë llogaritjet e tarifës. Përveç diferencës së mësipërme ju duhet të verifikoni që operatori ekonomik Rean 95 shpk është i specializuar që nga viti 1995 për vepra hidroteknike në gjithë veprimtarinë e saj dhe skualifikimi është ofendues për ne. Kërkojmë rivlerësimin e tenderit me cmim më të ulët X të vlerësuar sipas VKM 354 datë 11.05.2016 duke marrë cmimin më të ulët të vlerësuar pasi diferenca është e papërfillshme ose anulimin e tenderit Loti II me qëllim mosdiskriminim tonë.*

II.6. Në datën 23.05.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.19426/2 i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik.

II.7. Në datën 28.05.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.22012/1 prot., datë 06.06.2018 protokolluar me tonën me nr.1009/2 datë 08.06.2018 me objekt "Dërgohet informacion", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Në datën 25.07.2018, me shkresën nr. 1009/3 prot., Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor dokumentacion shtesë në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr.28962/1 prot., datë 30.07.2018 protokolluar me tonën me nr.1009/4 datë 31.07.2018 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rean 95” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Operatori ekonomik nuk ploteson Seksionin dy të dokumentave standarte të tenderit: II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË Seksioni 1. Hartimi i ofertës Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë. Duke rënë në kundërshtim me Kriteret e përcaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit si dhe VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin me nr 402 datë 13.05.2015 me vendimin nr 823, datë 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797 datë 29.12.2017 Në rastin konkret operatori ekonomik ka paraqitur dy formulare oferte sipas shtojcës 1 përkatësisht 166.350 leke pa tvsh si dhe 78.143,33 leke pa tvsh.

Gjithashtu në të dy rastet e mësipërme të ofertave ekonomike: Operatori ekonomik “Rean” Studio shpk, nuk ka respektuar VKM Nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”, cituar në paragrafin e fundit të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. “Shënim: Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. Datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Kjo Bazuar në njoftimin e bërë me Nr. 5585 datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë 11.05.2016 “Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”, si dhe njoftimit Nr. Prot 13565 datë 06.11.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Terheqje Vemendje”, ku kërkohet detyrimisht zbatimi i akteve ligjore, nenligjore dhe VKM 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”. Sa me sipër u Konstatua se Vlera e ofertës ekonomike të ofertuar nga Operatori Ekonomik nuk është në përputhje me VKM 354 datë 11.05.2016 “Për

miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" pasi eshte me e ulet se vlera minimale e perlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor, per kete procedure. Bazuar ne Rekomandimin e APP-se Nr. 5585 date 25.07.2017 "Mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Per Miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim, pika 2, Shprehimisht thuhet se: "Ne rrethana te jashtezakonshme dhe nese dokumentohet me shkrim, tarifat mund te jene me ultra se sa normat minimale, te specifikuara nga ky manual" Ne rastin kur operatori ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanen e jashtezakonshme, Autoriteti Kontraktor gjate vleresimit te ofertes duhet ti referohet vleres minimale te perlllogaritur per kete procedure prokurimi ne baze te parashikimit te VKM Nr. 354 date 11.05.2017 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" Ne rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nese ndodhet ne rrethana te jashtezakonshme per proceduren e prokurimit me objekt: Loti i Dytë: "Mbikqyrja e punimeve për objektin: "Rehabilitimi i pjesshëm i skemave ujitëse dhe sifonave të Mustafa Koç, Rovë (Ballçiflik), Alltatë", Per sa me siper theksojme se eshte detyre e operatorit ekonomik te garantoje qe oferta e paraqitur te jete ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi si rrjedhoje konkudojme se dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik "Rean" Studio shpk, nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Respektim te VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 11.05.2018 operatori ekonomik "Rean 95" shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- Operatori ekonomik nuk ploteson Seksionin dy te dokumentave standarte te tenderit: II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË Seksioni 1. Hartimi i ofertës Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë. Duke rënë në kundërshtim me Kriteret e percaktuara ne Dokumentat Standarte te Tenderit si dhe VKM Nr. 914 date 29.12.2014 per "Miratimin e rregullave te prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin me nr 402 date 13.05.2015 me vendimin nr 823, date 23.11.2016 dhe me vendimin nr. 797 date 29.12.2017. Ne rastin konkret operatori ekonomik ka paraqitur dy formulare oferte sipas shtojces 1 perkatesisht 166.350 leke pa tvsh si dhe 78.143,33 leke pa tvsh. Gjithashtu ne te dy rastet e mesiperme te ofertave ekonomike:
- Operatori ekonomik "Rean" Studio shpk, nuk ka respektuar VKM Nr. 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", cituar ne paragrafin e fundit te Kriteve te Vecanta te Kualifikimit te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor. "Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. Datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e percaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim". Kjo Bazuar ne njoftimin e bere me Nr. 5585 date 25.07.2017 te Agjensise se Prokurimit Publik "Rekomandim mbi menyren e percaktimit te

*tarifave minimale te Specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 354 date 11.05.2016 "Per Miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim", si dhe njoftimit Nr. Prot 13565 date 06.11.2017 te Agjensise se Prokurimit Publik "Terheqje Vemendje", ku kerkohet detyrimisht zbatimi i akteve ligjore, nenligjore dhe VKM 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim". Sa me siper u Konstatua se Vlera e ofertes ekonomike te ofertuar nga Operatori Ekonomik nuk eshte ne perputhje me VKM 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" pasi eshte me e ulet se vlera minimale e perlloritur nga Autoriteti Kontraktor, per kete procedure. Bazuar ne Rekomandimin e APP-se Nr. 5585 date 25.07.2017 "Mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Per Miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim, pika 2, Shprehimisht thuhet se: "Ne rrethana te jashtezakonshme dhe nese dokumentohet me shkrim, tarifat mund te jene me ulta se sa normat minimale, te specifikuara nga ky manual" Ne rastin kur operatori ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanen e jashtezakonshme, Autoriteti Kontraktor gjate vleresimit te ofertes duhet ti referohet vleres minimale te perlloritur per kete procedure prokurimi ne baze te parashikimit te VKM Nr. 354 date 11.05.2017 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" Ne rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nese ndodhet ne rrethana te jashtezakonshme per proceduren e prokurimit me objekt: Loti i Dytë: "Mbikqyrja e punimeve për objektin: "Rehabilitimi i pjesshëm i skemave ujitëse dhe sifonave të Mustafa Koç, Rovë (Ballçiflik), Alltatë", Per sa me siper theksojme se eshte detyre e operatorit ekonomik te garantoje qe oferta e paraqitur te jete ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi si rrjedhoje konkudojme se dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik "Rean" Studio shpk, nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Respektim te VKM Nr.354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim".*

III.1.2. Në datën 16.05.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Ju bëjmë me dije se udhëzimi nr.5585 datë 25.07.2017 i përket procedurës blerje e vogël jo kërkesë për propozime. Megjithatë diferenca prej 316 lekë pa tvsh më pak se vlera e konkurentit të kualifikuar nuk përbën shkak për skualifikim. AK për ta vlerësuar tenderin duhet të botojë edhe fondin limit të investimit me qëllim që cdo operator të bëjë llogaritjet e tarifës. Përveç diferencës së mësipërme ju duhet të verifikoni që operatori ekonomik Rean 95 shpk është i specializuar që nga viti 1995 për vepra hidroteknike në gjithë veprimtarinë e saj dhe skualifikimi është ofendues për ne. Kërkojmë rivlerësimin e tenderit me cmim më të ulët X të vlerësuar sipas VKM 354 datë 11.05.2016 duke marrë cmimin më të ulët të*

*vlerësuar pasi diferenca është e papërfillshme ose anulimin e tenderit Loti II me qëllim mosdiskriminim tonë.*

III.1.3. Në datën 28.05.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.1.4. Sa më sipër, konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Rean 95” sh.p.k në ankimin e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, nuk ka ankimuar të gjitha arsyet e skualifikimit të tij e konkretisht për pretendimin e autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ka paraqitur dy oferta ekonomike për procedurën e prokurimit objekt ankimi. KPP vëren se ankimuesi ka ngritur pretendime vetëm për arsyen e skualifikimit se oferta e paraqitur prej tij është nën kufirin minimal të parashikuar nga VKM nr. 354 date 11.05.2016 *“Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”*.

Për sa më sipër, KPP gjykon se ankimi i paraqitur prej tij nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi në autoritetin kontraktor dhe KPP nuk është realizuar sipas kriteve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*. Mosankimimi në tërësi i arsyeve të skualifikimit bën që operatori ekonomik “Rean 95” sh.p.k. të mbetet i skualifikuar cilido qoftë fati i asyes tjetër të skualifikimit për të cilën ankimuesi ka iniciuar procedimin administrativ.

III.1.5. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, me titull *“Të drejtat e personit të interesuar”* parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimi i parashtruar në ankimin e tij në lidhje me atë pjesë të arsyes së skualifikimit që lidhet me paraqitjen e ofertës nën minimumin e lejuar nga VKM-ja e sipërcituar, do të pranohet nga KPP, ankimuesi sërisht nuk do të ishte fitues i kontratës pasi për arsyen tjetër të skualifikimit të kësaj shoqërie se ka paraqitur dy oferta, nuk është ngritur asnjë pretendim pranë autoritetit kontraktor, cka sjell se gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Rean 95” sh.p.k. do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,



## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rean” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr. REF-63112-04-17-2018 me objekt “*Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i pjesshëm i skemave ujitëse dhe sifonave të Mustafa Koç, Rovë (Ballcifik), Alltatë”*”, me fond limit 183,333 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 30.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1009 Protokoli, Datë 28.05.2018**

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**